UDHËZIM
Nr. 17, datë 26.5.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 15.10.2021, "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, "Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Në fund të shkronjës "b", të pikës 5, të kreut I, bëhet shtesa si më poshtë:

"*... me përjashtim të diplomave/certifikatave profesionale, diplomave, gradave shkencore të lëshuara nga institucione të arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi.*".

b) Paragrafi i dytë i shkronjës "a" të pikës 1, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

"Përjashtimisht, procedura përfundon brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit, për diploma/certifikata profesionale të të gjitha formave të studimit të fituara në vendet e BE-së dhe SHBA-së, Britani e Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi, në rast se diploma/certifikata profesionale dhe suplementi ose lista e notave të saj janë të pajisura me vulë apostile. Në rastet kur QSHA-ja evidenton parregullsi/mangësi në dokumentacionin e paraqitur, mund të nisë procesin e verifikimit të tij, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

c) Në fund të fjalisë në shkronjën "a" të pikës 2, të kreut III, shtohen fjalët si më poshtë:

"... me përjashtim të programeve të studimit të përfunduara në institucionet e arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi.".

d) Shtojca nr. 3, zëvendësohet me shtojcën nr. 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse..

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ana Kapaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Shtojca nr. 3

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. _____prot., Nr._____Regjistri Tiranë më __.__._____

VËRTETIM NJOHJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së Z/Znj._____ (emër atësi,mbiemër), lëshuar nga_____(institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën),_____ (shteti), më datë ___.___._____ (data e lëshimit të diplomës/certifikatës), me program_____ vjeçar (kohëzgjatja e programit të studimit, ____ECTS (numri i krediteve të fituara në rast kur këto disponohen), me formë studimi _____ në (emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si _____në Republikën e Shqipërisë.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën/ certifikatën e njohur dhe njësuar.

Drejtor i Përgjithshëm